



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 4920 prot

Ballsh më 1809 / 2026

Nr. 09 datë 18 / 09 / 2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 18 / 09 / 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 24 / 09 / 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Maxhmi Seta)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 4920/11 prot.

Ballsh më 18.09.2026

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e Enjte, **datë 24.09.2026, ora 14:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 28.08.2026.
3. **Projektvendim Nr.52:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik, Komisioni Ekonomisë.
4. **Projektvendim Nr.53:** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Mallakastër për zbatimin e projektit: Askush të mos mbetet pas.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.
5. **Projektvendim Nr.54:** Për miratimin e akordimit të vlerës financiare prej 40000 lekësh për mbulimin e shpenzimeve të funeralit të të ndjerit Qani Rustem Hasani, qyteti Ballsh, Bashkia Mallakastër.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Ekonomisë.
6. **Projektvendim Nr.55:** Për miratimin e një shtese në buxhet për vitin 2026, sipas projektit “Rikonstruksion i qendrës komunitare Ballsh”, të financuara nga UNDP.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Ekonomisë.
7. **Projektvendim Nr.56:** Për miratimin e rishpërndarjes të fondeve buxhetore për vitin 2026.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Ekonomisë.
8. **Projektvendim Nr.57:** Për miratimin e dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Ekonomisë.

Mbledhja e komisioneve më datë 23.09.2026 ora 14:00.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

